

L ë n d a: Mbledhja e Komisionit Kombëtar të Nomenklaturave

KKN

Minutat e takimit

Datë 31.03.2021

Më datë 31 Mars u mbajt takimi i parë për vitin 2021 i Komisionit Kombëtar për Nomenklaturat, KKN. Drejtori i përgjithshëm i Institutit të Statistikave, INSTAT, njëkohësisht edhe Kryetar i KKN, Znj. Elsa Dhuli përshëndeti anëtarët e KKN-së. Pas miratimit të agjendës nga të gjithë pjesëmarrësit, mbledhja vijoi sipas rendit të ditës.

Në mbledhjen e radhës së KKN-së u diskutua:

1. Miratimi i projekt rregullore për funksionimin e Komisionit Kombëtar të Nomenklaturave

Kryetarja e KKN-së Znj. Elsa Dhuli vijoi diskutimin në lidhje me komentet e dërguara nga anëtarët e Komisionit për projekt rregulloren e Komisionit. Komentet e sugjeruara nga Znj. Alketa Tari u konsideruan të pranueshme nga ana e INSTAT dhe të gjithë anëtarët e tjerë nëpërmjet votimit online votuan pro.

Në parim rregullorja u shpall e miratuar duke reflektuar komentet dhe versioni final do ju dërgohet anëtarëve nëpërmjet postës elektronike.

2. Zgjedhja e zv kryetarit të KKN

Kryetari KKN propozoi si zv kryetar përfaqësuesen e BSH, Znj Rahela Reçi, propozim i cili u bazua në faktin që BSH është agjenci statistikore shumë e rëndësishme në prodhimin e statistikave zyrtare.

Pas hedhjes në votim, propozimi u miratua nga të gjithë anëtarët e pranishëm.

Znj Reçi shprehu mirënjohjen dhe falënderoi të gjithë anëtarët për besimin .

3. Nomenklaturat që do të trajtohen gjatë vitit 2021

Çështja e tretë kishte të bënte me nomenklaturat e reja të cilat do jenë në fokus gjatë vitit 2021. Bazuar në informacionet që janë marrë nga sekretariati nuk ka ardhur ende asnjë propozim



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

lidhur me këtë çështje. Znj. Dhuli ju kërkoi dhe një herë anëtarëve që të shprehin nevojat për nomenklatura të reja dhe theksoi faktin që kjo çështje do diskutohet sërish gjatë vitit. Anëtarët e KKN-së në çdo moment mund të diskutojnë çështje mbi nomenklatura të reja apo ndryshime në nomenklatura që zbatohen.

4. Miratimi i planit të punës së veprimtarisë së KKN 2021

Plani i Punës është rishikuar nga anëtarët e KKN dhe janë pasqyruar sugjerimet e tyre.

Një pjesë e detyrave të përcaktuara në planin e punës janë renditur për diskutim në takimin e parë, pasi janë procedura miratimi e nevojitet të aprovohen në mbledhjen e parë të vitit.

Nëse gjatë vitit anëtarët do shprehin propozime për rishikim apo ndryshim plani, INSTAT-i do të jetë i hapur për ta rishikuar dhe diskutuar së bashku.

5. Miratimi i nomenklatures GEONOM

Në lidhje me nomenklaturën GEONOM në mbledhje ishte ftuar Z. Elton Alik, Drejtor në Drejtorinë e Statistikave të Sektorit Real. Kjo është drejtoria e cila mbulon nomenklaturën GEONOM, dokumenti i të cilës raportohet edhe në raportin e progresit të Komisionit Evropian. GEONOM është pjesë edhe e PKIE dhe është planifikuar që të miratohet këtë vit me VKM.

6. Trajnimet për vitin 2021

Znj. Dhuli shpjegoi për anëtarët se INSTAT çdo vit harton planin e trajnimeve bazuar në strategjinë afatgjatë të trajnimeve që institucioni ka ndërtuar. Në kuadër të rritjes së kapaciteteve, INSTAT ofron përveç trajnimeve lidhur me nomenklaturën dhe trajnime për programe kompjuterike (Excel, gjuha R dhe SPSS).

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al